



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1283/2 Prot

Rrëshen, më 29 . 04 . 2026

**V E N D I M**

**Nr. 25 datë 24. 04. 2026**

**PËR**

**“VENDOSJEN E NJË SHTATOREJE NË NDER DHE PËRKUJTIM TË ABAT PREND DOÇI, NË SHESHIN E QYTETIT RRËSHEN, I EMËRTUAR ME TË NJËJTIN EMËR “ABAT PREND DOÇI” BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, nenit 25, pika 1, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, me vendndodhje në ZK nr. 3224, dhe në vijim të relacionit nr. 1283 prot. datë 18. 03. 2026, të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, pas diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë vendosjen e një shtatoreje në nder dhe përkujtim të Abat Prend Doçi, në sheshin e qytetit Rrëshen, i emërtuar me të njëjtin emër “Abat Prend Doçi”, Bashkia Mirditë, sipas relacionit nr. 1283 prot, datë 18.03.2026 dhe vendndodhjes së përcaktuar në Planin e Vendosijes së Shtatores, në shk. 1:100 bashkëlidhur, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Vendosija e shtatores të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të shoqërohet me gjithë dokumentacionin e kërkuar nga legjislacioni në fuqi, për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë; (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Agjencia e Punëve Publike & Mirëmbajtjes, Mirditë - APPM-M)

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar!*

**SEKRETAR**

**Gaspër TOPOLLAJ**



**KRYETAR**

**Aleksandër PICA KU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1283/1 Prot

Rrëshen, më 18.03. 2026

**P/VENDIM**

Nr. 35, datë 18.03. 2026

**PËR**

**“VENDOSJEN E NJË SHTATOREJE NË NDER DHE PËRKUJTIM TË ABAT PREND DOÇI, NË SHESHIN E QYTETIT RRËSHEN, I EMËRTUAR ME TË NJËJTIN EMËR “ABAT PREND DOÇI” BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, nenit 25, pika 1, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3224, me numër pasurie ..... dhe në vijim të relacionit nr. 1283 prot. datë 18.03. 2026 të Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, pas diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë vendosjen e një shtatoreje në nder dhe përkujtim të Abat Prend Doçi, në sheshin e qytetit Rrëshen, i emërtuar me të njëjtin emër “Abat Prend Doçi”, Bashkia Mirditë, sipas vendndodhjes së përcaktuar në Genplanin/Planvendosjes bashkëlidhur, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Vendosja e shtatores të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të shoqërohet me gjithë dokumentacionin e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet; Kryetari i Bashkisë (Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes, Mirditë)

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar!*

**SEKRETARI**  
Gaspër TOPOLLAJ

**KRYETARI**  
Aleksandër PCAKU

*Paraqitën Projektin:*

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit: Juljan Tusha  
Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve.: Julian Vlaski  
Drejtoria B/Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët: Lorena Gjergji

**KRYETARI**  
Albert MËLYSHI





REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA MIRDITË

Nr. 1283 Prot.

Rrëshen, më 16 .03 .2026

**Lënda: RELACION ARKITEKTONIK MBI PROJEKT-PROPOZIMIN E VENDOSJES SË SHTATORES SË "ABAT PREND DOÇI" NË SHESHIN ME TË NJËJTIN EMER NË RRËSHEN, MIRDITË.**

Hyrje: Pranë Bashkisë Mirditë shtë paraqitur për shqyrtim një propozim për vendosjen e një shtatoreje (bust) në nder të figurës së Abat Doçi, si pjesë e iniciativave për promovimin e vlerave historike dhe kulturore në hapësirat publike të qytetit.

Dokumentacioni teknik dhe konceptual mbi këtë propozim është hartuar nga një grup i jashtëm pune, me pjesëmarrjen e një arkitekti privat të licencuar (Maksim KOLA), dhe i është paraqitur institucionit për vlerësim nga pikëpamja urbanistike dhe procedurale.

Jam përfshirë si arkitekt në këtë bashkepunim me bashkinë Mirditë, por dhe me skulptorin i cili u zgjodh për të bërë këtë veper, jo vetëm për faktin që jam i lindur dhe rritur në këtë qytet, por se në këto vepra skulpturore është i domosdoshëm bashkepunimi me arkitektin, urbanistin, pasi një shtatore ose një bust duhet vendosur mbi një platformë të caktuar dhe duhet zgjidhur pozicioni si pasoje e gjykimit dhe analizës që mund t'i bëjë një arkitekt.

Në këtë hapësirë sheshi, e rrethuar me objekte shoqërore dhe banimi, akse rrugore të caktuara që kalojnë tangent këtij sheshi, apo që hyjnë në këtë shesh nëpërmjet këtyre rrugëve, ishte shumë e rëndësishme për të gjykuar se si dhe se ku duhet të jetë e pozicionuar kjo shtatore.

Sheshi quhet prej vitësh sheshi "Abat Doci". Ky shesh ka kaluar në një rikonstruksion para pak viteve dhe do ishte ideale që menjëherë me rikonstruksionin e sheshit, të ishte bërë edhe kjo punë që po bëjmë sot. I gjendur para faktit të kryer, më është dashur që të bëj një zgjidhje të tillë që mos të ishte në perplasje konceptesh me çfarë është bërë deri sot dhe duke mos i rihyrë prap ndërhyrjeve ndërtimore të sheshit përsëri. Sepse ndër të tjerave është edhe kosto, qoftë kohore ashtu dhe monetare. Në këtë pikëpamje gjykova që të përfshij si pjesë të zgjidhjes së këtij projekti edhe volumetrinë që është krijuar me shkallë të larta rreth 35 centimetra që shërben edhe për tu ulur, e që vjen në një formë gjysmëharku të hapur, nëpërmjet tre segmenteve, ku është krijuar kjo shkallë në 3 radhë, që i afrohet si koncept amfiteatrit ku nga pjesa e sipërme e saj krijohet një shesh i dytë para Bashkisë, që është ndare në një zonë të gjelbërt me disa pemë jo të miremenduara dhe pjesa e sheshtë për kalim këmbësorësh.

Pra në një farë mënyre është parashikuar ai shesh si pjesë e Bashkisë dhe për rjedhojë, busti nuk duhet vendë në aks me Bashkinë ose në pjesën e sheshit të bashkisë, pasi tradicionalisht i është mësuar qytetarëve

që sheshi është pjesa e poshtme. Pjesa më e madhe që rethohet nga ish Bashkia, nga ish Pallati i Kultures, ish Konvikti dhe objekti i banimit linear me sherbime në kat përdhe. Në këtë pikepamje është vlerësuar pozicionimi i bustit në raport me pikat e hyrjes në shesh, që janë tre pika kryesore. Ajo që vjen nga Muzeu i Qytetit mes hapësirës së Pallatit të Kultures dhe objektit linear Kryqëzimi nga Posta dhe e fundit, ajo nga Konvikti ose nga Komisariati i Policisë. Këto tre pika, i kam pasuruar me një plan skematik, ku në këto drejtime vijin flukset e njerëzve sipas rëndësisë. Nga pika e parë tek ajo e dyta e këtyre hyrjeve, tangent me sheshin, vjen me solemnitetin e tij Bulevardi i Qytetit që shpeshherë i themi "Xhiroja e Rrëshenit". Kjo theksohet edhe me faktin që në këtë shesh është vendosur një shatërvan, në formë drejtkëndëshi linear, paralel me bulevardin. Kur shatërvani vendoset në punë, provokon si me zhurmën e tij ashtu edhe me pamjen që krijon dhe në këtë moment. Është studiuar që edhe kjo skulpturë me aks kryesor bustin e Abat Doçit të jetë në sfond mbas shatërvanit, duke e theksuar akoma më shumë kontekstin artistik.

Me këtë pozicionim kemi analizuar si sfond ekzistues edhe objektet që janë përreth. Pra, ky bust nuk i perket as Bashkisë, as Ish Bashkisë, as Konviktit, as Pallatit të Kulturës, e as pallateve nga lindja. Kam shmangur pozicionimin amatoresk që vjen në qendër të sheshit kur sheshi nuk është simetrik nga të gjitha anët. Pasi është bërë asimetrik për shkak të shkallares që ngjan pak me amfiteatrin në krah të

Bashkisë. Dhe sic e thamë më sipër, e kemi përfshirë si volum në pjesën e zgjidhjes së saj arkitekturore në dy volume dinamike. Ajo ekzistuesja horizontale, dhe kjo e reja në funksion të Shtatorës në ngjitje vertikale duke u ngushtuar nëpërmjet linjave ovale drejt Hyjit. Duke qenë se kemi arritur në këtë pikë, pozicioni ku do vendoset Shtatorja ka për sfond jo një objekt, por një hapësirë të caktuar, kryesisht gjelbërim. Kjo shtatore do vendoset në një platformë horizontale në kuotën 60 cm mbi kuotën e lulishtes së vogël dhe pastaj zbret në kënd  $45^\circ$  deri në shesh me anë të një shkallareje. Ku më pas krijohet një platformë 25 cm mbi sheshin ekzistues që thekson akoma më tepër këtë strukturë që është në funksion të Shtatorës. Pozicionimi i shtatorës në kuotën 60 cm mbi kuotën e barit, është pozicioni mbi Altar që ka pasur gjithmone Priftin. Është e rëndësishme të theksohet figura priftërore, si dimension kryesor i jetës dhe biografisë së tij, si atdhetar e njeri i letrave.

Kjo platformë dinamike është pasuruar me rifiniturë të llojit pllake guri si travertine me dimensione të mëdha dhe ngjyre bezhe. Po ashtu do të pasurohet me elemente ndriçimi për të theksuar Shtatoren kryesore, elementin e shkallares, edhe vetë gjelbërimin, i cili do punohet nga e para.

Në sipërfaqen horizontale me bar strukturë rrethohet me një gjysmë rreth me lule të kuge e të zeza që simbolizojnë ngjyrat e flamurit tonë kombëtar. Ky detaj e freskon, pasuron e dekoron platformën. Ndërsa në dy anet e tjera kemi shkurre dekorative të krasitura, duke sjelle ngjyra të ndryshme në stinë të ndryshme të vitit, gjë që e bën me variabël këtë lulishtë në shesh. Ndriçimi do perdoret tek skulptura, tek shkurret dekorative, tek shkallet, pishat, për të krijuar variacion në shesh e për ta bërë këtë ansambel një bërthamë qëndrore në shesh.

Autori: Arkitekt, Urbanist Maksim KOLA

Vlerësimi urbanistik dhe teknik:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Drejtoria e Urbanistikës konstaton se: Propozimi është i përshtatshëm me funksionin e hapësirës publike ku synohet vendosja, nuk krijon pengesa në qarkullimin këmbësor apo funksionimin normal të zones, respekton kriteret bazë të kompozimit urban dhe integritimit në peizazhin ekzistues dhe është në përputhje me instrumentet e planifikimit në fuqi.

**Theksohet se materiali i paraqitur nga subjekti i jashtëm përbën një bazë konceptuale, e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin përfundimtar teknik në fazat e mëtejshme të zbatimit, gjithashtu propozimi i dakortësuar është variant 2 i paraqitur, pa skulptura të tjera përreth, dhe pa mur mbas shtatores, të cilat do ulnin hierarkinë monumentale të figures së ABATIT dhe do prishnin harmoninë arkitektonike të sheshit.**

Në përfundim, Drejtoria e Urbanistikës, bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur nga grupi i jashtëm dhe arkitekti privat, vlerëson se propozimi për vendosjen e shtatores (bustit) të Abat Doçi është i pranueshëm nga pikëpamja urbanistike dhe nuk paraqet pengesa për vijimin e mëtejshëm të procedurave ligjore për shqyrtim dhe miratim.

Konc. Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit : Ark. J. TUSHA  
Konf. Drejtor i Trashëgimisë Kulturore dhe Muzeve : J. VLASHI

